**VENDIM**
**Nr. 15, datë 10.3.2016**

# PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT PËR VITIN 2016, PËR DISA PROJEKTE NË VAZHDIM, TË GRANTIT "REHABILITIMI MJEDISOR, GJELBËRIM DHE PYLLËZIM", PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim, me cikël financimi 2015–2016, për grantin "Rehabilitimi mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim", Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, shtylla I, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Mjedisit dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
**Niko Peleshi**

| | |
|---|---|
| Zëvendëskryeministri | Zëvendëskryetar |
| Ministri i Financave | anëtar; |
| Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes | anëtar |
| Ministri i Zhvillimit Urban | anëtar; |
| Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës | anëtar; |
| Ministri i Arsimit dhe Sportit | anëtar; |
| Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave | anëtar; |
| Ministri i Shëndetësisë | anëtar; |
| Ministri i Kulturës | anëtar; |
| Ministri i Mjedisit | anëtar; |
| Ministri i Punëve të Brendshme | anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike | anëtar; |
| Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore | anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë | anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1 | anëtar; |
| Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2 | anëtar; |
| Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3 | anëtar; |
| Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4 | anëtar. |

**Tabela 1.** Lista e projekteve me cikël financimi 2015-2016, të financuar përmes grantit të rehabilitimit mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, financimi për vitin 2016.

| Nr. | Autoriteti Kontraktues | Emërtimi i projektit | Vlera e Projektit (lekë) | Vlera e Kontratës (lekë) | Vlera e realizuar për vitin 2015 (në Lekë) | Vlera e financimit për vitin 2016 (në Lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Rehabilitimi nëpërmjet pyllëzimeve i objektit Makaresh (Krastë-Krujë) | 30,000,000 | 29,460,000 | 20,797,269 | 8,662,731 |
| | | **Totali** | **30,000,000** | **29,460,000** | **20,797,269** | **8,662,731** |

**Shënim:**

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me Vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, dhe shërben si referencë për llogaritjen e vlerës së financimit për vitin e parë të projektit.
2. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, dhe "korrekton" vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Mjedisit).
3. "Vlera e realizuar për vitin 2015" tregon vlerën e realizuar për vitin 2015, deri në 31.12.2015. Vlera e realizuar përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Mjedisit).
4. "Vlera e financimit", për vitin 2016, tregon vlerën e mbetur të financimit, pas diferencës midis vlerës së kontratës dhe vlerës së realizuar për vitin 2015.